

ALARM TATIMOR

Dhjetor 2019

Për t'ju informuar me ndryshimet më të fundit në legjislacionin Shqipëtar, ky alarm tatimor i përgatitur nga "A.R.S Legal & Financial Services" Ltd, ju ofron informata të vlefshme për personat fizike dhe personat juridikë.

Në fletoren zyrtare Nr. 165 date 5.12.2019 është publikuar Vendimi Nr. 176, datë 14.11.2019 "Mbi miratimin e rregullores së lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror".

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktoj procedurën e aplikimit, kriteret për miratimin dhe realizimin e një lidhjeje të re ose modifikimin e një lidhjeje ekzistuese dhe përcaktimin e tarifave përkatëse për lidhjen e pajisjeve të përdoruesit të rrjetit të transmetimit ose të shpërndarjes në sektorin e gazit natyror.

Sipas nenit 6 të rregullores në varësi të presionit të rrjetit në pikën e lidhjes, kapacitetit të lidhjes, metodës së lidhjes dhe numrit të matësve të instaluar në një objekt të vetëm dhe të lidhur me një pajisje rregullimi, lidhjet do të grupohen në katër kategori:

- a) lidhje standarde;
- b) lidhje në grup;
- c) lidhje e personalizuar;
- d) lidhje sipas një rasti specifik

Në rast përjashtimore operatori i rrjetit mund të marrë në konsideratë dhe një lidhje tjetër jo të parashikuar në grupimin e mesipërm në ato raste kur bëhen aplikime një numër të konsideruashëm aplikantësh potenciale. Këto kategori të reja lidhjeje, do të konsiderohen pjesë e kësaj Rregulloreje, vetëm pas paraqitjes së kërkesës së argumentuar të operatorit të rrjetit dhe miratimit të ERE-s.

TAX ALERT

December 2019

To keep you up to date with the latest changes in Albanian legislation, this tax alert prepared by "A.R.S Legal & Financial Services" Ltd provides you with valuable information for natural persons and legal entities.

In the Official Journal No.165, dated 5.12.2019 is published the decision Nr. 176, dated 14.11.2019 "On the Adoption of regulation of new connections in the Natural Gas Sector".

The purpose of this Regulation is to set out the application procedure, the criteria for the approval and implementation of a new connection or the modification of an existing connection and the determination of the relevant tariffs for the connection of transmission or distribution network equipment users in the natural gas sector.

According to the article 6 of the regulation, depending on the grid pressure at the connection point, connection capacity, connection method and the number of meters installed on a single object and connected to a control device, the connections shall be grouped into four categories:

- a) standard connection;
- b) group connection;
- c) personalized connection;
- d) connection according to a specific case

In exceptional cases, the network operator may consider another connection not provided in the above grouping in cases where a significant number of potential applicants apply. These new connection categories shall be considered part of this Regulation only upon submission of the network operator's reasoned request and the ERE approval.

<p>Bazuar në nenin 7 të rregullores vlerësimi i një kërkesë për lidhje do të bëhet nga operatori përgjegjës i rrjetit rast pas rasti duke marrë parasysh perputhshmërinë e kërkesës me:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) ligjin nr. 32/2016, “Për garantimin e sigurisë së instalimeve nën presion”; b) rregullat teknike që garantojnë funksionimin e sigurt të pajisjeve dhe instalimeve të gazit natyror; <p>Si dhe duke marrë parasysh kritere si:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) vendndodhjen e objektit për të cilin kërkohet lidhja, duke përfshirë shtrirjen dhe koordinatat e kufijve të tij; b) largësinë nga rrjeti; c) kapacitetin e disponueshëm të rrjetit të operatorit përgjegjës në atë zonë; d) aspektet e sigurisë gjatë punimeve; e) aplikimet aktuale dhe potenciale të ardhshme për t’u lidhur në të njëjtën pikë lidhjeje etj <p><u>Procedura e shqyrtimit të kërkesave:</u></p> <p>Pas paraqitjes së një kërkesë për lidhje, operatori i rrjetit do të lëshojë menjëherë një konfirmim për pranimin e kërkesës, duke përmendur kohën e paraqitjes së tij dhe do të sigurojë informacione standarde, në lidhje me skedulën e parashikuar për vlerësimin e tij dhe hapat e tjerë parashikues të procesit, duke përfshirë kohën, lejet për të marrë etj.</p> <p>Jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga paraqitja e aplikimit, operatori i rrjetit do të:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) në rast të mungesave në dokumentacion, do të informojë aplikantin të paraqesë çdo të dhënë dhe/ose informacion të munguar b) konfirmojë plotësinë e aplikimit dhe bie dakord me aplikantin për ditën kur eksperti i operatorit të rrjetit mund të vizitojë vendin ku kërkohet lidhja. c) informojë aplikantin që çështja nuk kualifikohet si një lidhje 	<p>Based on article 7 of the Regulation the evaluation of a connection request shall be made by the responsible network operator on a case-by-case basis, taking into consideration the compliance of the request with:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Law no. 32/2016, “On ensuring the safety of pressure installations”; b) technical rules that guarantee the safe operation of natural gas equipment and installations; <p>As well as taking into consideration criteria such as:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) the location of the object for which the connection is required, including the extent and coordinates of its boundaries; b) distance from the network; c) the available network capacity of the responsible operator in that area; d) safety aspects during the works; <p><u>The procedure of request analyze:</u></p> <p>After submission of a request for connection, the network operator shall issue immediately a confirmation of receipt of the request, mentioning the time of his appearance and will provide standard information in relation to the schedule provided for its evaluation and other predictive steps of the process, including time, permits to obtain, etc.</p> <p>Within 15 calendar days from the submission of the application, the network operator shall:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) in the event of a lack of documentation, inform the applicant of any missing data and / or missing information b) confirm the completeness of the application and agree with the applicant on the day when the network operator's expert can visit the place where the connection is requested. c) inform the applicant that the case does not qualify as a connection
--	--

Pas marrjes së vendimit, brenda 15 ditëve kalendarike, aplikanti, kur merr një ofertë, mund:

- a) të pranojë ofertën duke firmosur dhe duke dërguar marrëveshjen e lidhjes në operatorin e rrjetit dhe duke ekzekutuar këstin e parë dhe duke përmbushur të gjitha aspektet e tjera, siç parashikohet në marrëveshjen e lidhjes.
- b) të kundërshtojë ofertën dhe i kërkon operatorit të rrjetit që të fillojë një procedurë konsultimi dhe negociim.
- c) të refuzojë ofertën. Nëse aplikanti nuk ndërmerr asnjë veprim, brenda 15 ditëve nga marrja e informacionit, atëherë do të konsiderohet si një refuzim automatik dhe aplikanti do të duhet të paraqesë përsëri një aplikim të ri, në qoftë se ai është përsëri i interesuar për një lidhje.
- d) kur kërkesa është refuzuar, të kërkojë sqarime shtesë nga operatori i rrjetit

Në rast se operatori i rrjetit dhe aplikuesi nuk arrijnë marrëveshje, aplikanti mund ta paraqesë çështjen në ERE.

Në fletoren zyrtare Nr. 169 datë 11.12.2019 është publikuar Udhëzimi Nr. 34, datë 5.12.2019 Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 6, Datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar.

Në udhëzim pasqyrohet ndryshimi i nenit 63 “Rimbursimi për Marrëveshjet Financiare”, pika 3 paragrafi i dytë si më poshtë:

Në zbatim të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, kur i kontraktuari/përfituesi i grantit (lider/

After making the decision, within 15 calendar days, the applicant, when receiving an offer, may:

- a) Accept the offer by signing and sending the connection agreement to the network operator and executing the first installment and fulfilling all other aspects as provided in the connection agreement.
- b) reject the offer and request the network operator to initiate a consultation and negotiation procedure.
- c) reject the offer. If the applicant does not take any action within 15 days of receiving the information, then it will be considered as an automatic refusal and the applicant will have to submit a new application again if he is again interested in a connection.
- d) when the connection request is rejected, request additional clarification from the network operator

If the network operator and the applicant fail to reach an agreement, the applicant may refer the matter to the ERE.

In the Official Journal No.169, dated 11.12.2019 is published the Instruction no. 34, dated 5.12.2019 On an amendment to Instruction no. 6, dated 30.1.2015 “On value added tax in the Republic of Albania”, changed.

The Instruction reflects the amendment of Article 63 “Refund on Financial Agreements”, point 3, second paragraph as follows:

Pursuant to financial agreements ratified by the Assembly or grant agreements approved by the Council of Ministers, which provide for the non-use of foreign financial resources to pay tax when the contractor/grantee (leader/ coordinator, co-applicant/co-beneficiary or sub-grantee) of the

koordinator, bashkëaplikant/ bashkëpërfitues apo nënpërfitues granti) të donatorit të përcaktuar në këto marrëveshje, është një organizatë jofitimprurëse (OJF), që ka lidhur një kontratë të financuar me fonde të donatorit, pavarësisht statusit të saj në kontratë, OJF-ja gëzon të drejtën e rimbursimit të TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në kuadër të kësaj kontrate.

Për çdo kontratë granti mund të ketë vetëm një numër identifikimi për efekt rimbursimi, por disa OJF aplikante për t'u pajisur me certifikatë për rimbursim TVSH-je në varësi të statusit të tyre në kontratë. Nëse aplikanti është një OJF, palë në kontratë me statusin lider/koordinator, certifikata e saj për rimbursim është e vlefshme edhe për TVSH-në e paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në Shqipëri në kuadër të kësaj kontrate nga OJF-të e tjera vendase, palë në kontratë me statusin bashkëpërfituese apo nënpërfituese të grantit.

Në rast se OJF-ja, palë në kontratë me statusin lider/koordinator është organizatë e huaj që ushtron veprimtarinë jashtë territorit të Shqipërisë apo që ushtron një a disa veprimtari të caktuara në territorin shqiptar, e peregjistruar sipas të drejtës shqiptare me një degë a OJF të re, të drejtën e aplikimit e gëzon OJF-ja/të vendase, palë në kontratë me statusin bashkëpërfituese, për pjesën e TVSH-së së paguar prej saj/tyre dhe prej nënpërfituesve të grantit (OJF-të vendase, nëse ka) në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në Shqipëri në kuadër të kësaj kontrate.

Edhe në rastin kur lideri/koordinatori nuk e gëzon statusin e OJF-së sipas kuptimit të ligjit për organizatat jofitimprurëse, të drejtën e aplikimit e gëzon OJF-ja/të vendase palë në kontratë me statusin bashkëpërfituese, për pjesën e TVSH-së së paguar prej saj/tyre dhe prej nënpërfituesve të grantit (OJF-të vendase, nëse

donor specified in these agreements is a non-profit organization (NGO) which has entered into a contract funded by donor funds, regardless of its contract status, the NGO enjoys the right to reimbursement of VAT paid on the purchase of goods and services under this contract.

For each grant contract there may be only one identification number for the reimbursement effect, but some NGOs apply to obtain a VAT refund certificate depending on their contract status. If the applicant is an NGO, party to the contract with lead/coordinator status, her refund certificate is also valid for VAT paid on the purchase of goods and services in Albania under this contract by other domestic NGOs, party to the contract with the co-beneficiary or sub-beneficiary status of the grant.

In case the NGO, the party to the contract with the lead/coordinator status is a foreign organization that operates outside the territory of Albania or exercises one or more specific activities in the Albanian territory, not registered under Albanian law with a branch or a new NGO, the right to apply is enjoyed by local NGOs, parties to the contract with co-beneficiary status, for the part of VAT paid by her / them and by grant beneficiaries (local NGOs, if any) in purchase of goods and services in Albania under this contract.

Even if the leader/coordinator does not enjoy the status of NGO in the sense of the law on non-profit organizations, the right to apply is granted by the local NGO, party to the contract with the co-beneficiary status for the part of paid VAT by her/them and the grant beneficiaries (local NGOs, if any) in the purchase of goods and services in Albania under this contract.

Regardless the method of application, individually or through another NGO (party to the same

<p>ka) në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në Shqipëri në kuadër të kësaj kontrate.</p> <p>Pavarësisht mënyrës së aplikimit, individualisht apo nëpërmjet një OJF-je tjetër (palë në të njëjtën kontratë), OJF-të që përfitojnë rimbursimin e TVSH-së sipas këtij udhëzimi, janë individualisht përgjegjëse para organit tatimor për pjesën e tyre të deklarimit për efekt të TVSH-së së rimbursueshme.</p> <p>OJF-ja, pjesë e kontratës së grantit me donatorin apo institucionin/entitetin e autorizuar/ deleguar zyrtarisht prej tij, brenda 90 ditëve kalendarike nga data përfundimtare e pranueshmërisë së shpenzimeve, aplikon pranë drejtorisë rajonale tatimore (DRT) përkatëse, për regjistrim për efekt rimbursimi TVSH-je.</p> <p><u>Brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT kryen verifikimin e dokumentacionit të paraqitur dhe procedon me rimbursimin e TVSH-së në llogarinë bankare të çdo OJF-je, të vënë në dispozitim në kërkesën për rimbursim.</u></p> <p><i>Në fletoren zyrtare Nr. 171 datë 16.12.2019 është publikuar Vendimi Nr. 807, datë 11.12.2019 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore".</i></p> <p><u>Qëllimi</u> i këtij vendimi është të përcaktoj kushtet, kriteret dhe procedurën e aplikimit për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore.</p> <p>Në pikën një të vendimit parashikohet se pronari/pronarët e një prone private, si dhe çdo subjekt zhvillues, i cili ka marrë të drejtën për të zhvilluar një pronë të tillë, gëzojnë të drejtën që të kërkojnë kalimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, të cilat plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:</p>	<p>contract), NGOs benefiting from VAT refunds under this instruction are individually liable to the tax authority for their portion of the declaration of effect Refundable VAT.</p> <p>The NGO, part of the grant contract with the donor or institution/entity officially authorized /delegated by him, within 90 calendar days from the final date of eligibility of expenses, applies to the relevant Regional Tax Directorate (DRT), for VAT refund registration.</p> <p><u>Within 30 days of receipt of the request, the VAT Reimbursement Directorate, verifies the submitted documentation and proceeds with the VAT refund to the bank account of each NGO made available in the request for reimbursement.</u></p> <p><i>In the Official Journal No.171, dated 16.12.2019 is published the decision Nr. 807, dated 14.11.2019 "On the Determination of criteria and conditions for the transfer of state property to private property, in the function of general local plans."</i></p> <p><u>The purpose</u> of this decision is to determine the conditions, criteria and application procedure for the transfer of state property to private property, in function of the general local plans.</p> <p>Point one of the decision provides that the owner (s) of a private property, as well as any developer entity that has acquired the right to develop such property, have the right to request the transfer of the state property to private property. , which meet all of the following conditions:</p>
---	--

<p>a) sipërfaqja e pronës shtetërore është në pronësi të shtetit dhe nuk është transferuar në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore.</p> <p>b) sipërfaqja e pronës shtetërore është në pronësi të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe ato kanë dhënë pëlqimin për kalimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, sipas procedurave që parashikohen në këtë vendim;</p> <p>c) sipërfaqja e pronës shtetërore është në kufi me pronën private që do të zhvillohet nga subjekti kërkues;</p> <p>ç) për zonën ku ndodhet sipërfaqja e pronës shtetërore që kërkohet të tjetërsohet ekziston një plan i përgjithshëm vendor për zhvillimin e territorit i miratuar nga organet përkatëse për planifikimin e territorit;</p> <p>d) sipërfaqja e përgjithshme e pronës shtetërore, që kërkohet të kalohet nga pronë shtetërore në pronë private, nuk duhet të jetë më e madhe se 20% e sipërfaqes totale të pronës private që do të zhvillohet, sipas rastit, nga pronari i tyre apo subjekti zhvillues;</p> <p>dh) sipërfaqja e pronës shtetërore nuk kryen më asnjë funksion publik apo ka humbur funksionet për të cilat është përdorur;</p> <p>e) Agjencia e Zhvillimit të Territorit ka dhënë miratimin e saj për konformitetin e projektit që kërkohet të zhvillohet.</p> <p>Procedura: Subjekti i cili i plotëson të gjithë kushtet e sipërpërmendura paraqet kërkesën e tij pranë ministrit të përgjegjës për financat, të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm. Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar prej tij.</p>	<p>a) the surface of the state property is state owned and has not been transferred to the local self-government unit.</p> <p>b) the surface of the state property is owned by the units of local self-government and they have given their consent for the transfer of the state property surfaces to private property, in accordance with the procedures provided for in this decision;</p> <p>c) the surface of the state property is on the border with the private property that will be developed by the requesting entity;</p> <p>ç) for the area where the state property surface is located that required to be alienated there is a general local plan for the development of the territory approved by relevant planning territory authorities</p> <p>d) the total surface of state property required to be transferred from state property to private property shall not exceed 20% of the total surface of private property to be developed, as the case may be, by their owner or entity developer;</p> <p>dh) the surface of state property does not perform with no public function or lost the functions for which it was used;</p> <p>e) The Territorial Development Agency has given its approval for the conformity of the project required to be developed.</p> <p>Procedure: The entity that meets all the above conditions submit its request to the ministry responsible for finance, together with the necessary documentation. The submitted documentation must be original or notarized copy.</p>
---	---

Pas paraqitjes së kërkesës sipas pikës 6 të vendimit bëhet shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave duke vërtetuar plotësimin e kushteve të parashikuara në pikën një. Veprimet e vlerësimit konsistojnë edhe në veprime verifikimi në terren.

Pas kryerjes së verifikimeve, me propozim të ministrit përgjegjës për financat, Këshilli i Ministrave miraton kalimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, së bashku me projektkontratën që do të lidhet për këtë qëllim. Pas miratimit të vendimit nga Këshilli i Ministrave, për kalimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, njoftohet kërkuesi që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit, të nënshkruajë me strukturën përgjegjëse për tjetërsimin e pronave shtetërore në ministrinë përgjegjëse për financat, kontratën për kalimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private.

Në kontratë do të përcaktohet çmimi i sipërfaqes së pronës shtetërore që do të kalohet te kërkuesi, i cili do të jetë në përputhje me çmimin e përcaktuar në hartën e vlerës së pronës përkatëse, të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Kontrata përcakton, gjithashtu, kushtin për momentin e kalimit të pronësisë së pronës shtetërore, që në çdo rast do të lidhet me realizimin e projektit, në funksion të të cilit është kërkuar kalimi i pronës shtetërorë në pronë private. Kontrata, pas nënshkrimit të saj, regjistrohet në zyrën përkatëse të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me shënimin përkatës. Nëse miratimi i lejes për zhvillimin e projektit, në funksion të të cilit është kërkuar kalimi i pronës shtetërorë në pronë private, nuk bëhet brenda 5 (pesë) viteve nga nënshkrimi i kontratës, atëherë kontrata zgjidhet dhe palët i kthejnë njëra-tjetrës çdo gjë që i kanë dhënë si pasojë e kësaj kontrate.

Në fletoren zyrtare Nr. 173 datë 18.12.2019 është publikuar Akti Normativ Nr. 10, datë

After the submission of the request according to point 6 of the decision, the requests are reviewed and evaluated, confirming the fulfillment of the conditions provided for in point one. Evaluation actions also consist of field verification actions.

Upon verification, on the proposal of the minister in charge of finance, the Council of Ministers approves the transfer of state-owned property to private property, together with the draft contract that will be concluded for this purpose. Upon approval by the Council of Ministers of the transfer of state-owned property to private property, the applicant shall ,within 30 (thirty) days of notification, to sign with the body responsible for the alienation of state property in the ministry responsible for finance, the contract for the transfer of state property surfaces to private property.

The contract shall specify the price of the state property area to be passed on to the applicant, which shall be in accordance with the price specified in the map of the value of the respective property approved by the Council of Ministers. The contract also specifies the condition for the moment of transfer of ownership of state property, which in any case will be related to the realization of the project, in the function of which the transfer of state property to private property is required. The contract, after being signed, shall be registered with the relevant office of the State Cadastre Agency, with the relevant note. If the approval of the project development permit, which requires the transfer of state property to private property, is not made within 5 (five) years from the signing of the contract, then the contract is terminated and the parties return to each other they have been given as a result of this contract.

In the Official Journal No.173, dated 18.12.2019 is published Normative Act No. 10, dated 18.12.2019

18.12.2019 “Për disa shtesa në ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Sipas këtij akti do të përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat:

- Të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme.

Për të përfituar nga ky përjashtim, përfituesit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë përfitues të pensionit sipas legjislacionit në fuqi në vendet ku e kanë përfituar atë;
- b) të jenë pajisur me leje qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) të mos kenë qenë ndonjëherë të dënuar në shtetin e vet apo në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet tjetër për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie;
- d) të kenë marrë përgjigje pozitive nga struktura përgjegjëse administrative për përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat personale të përfitimit të pensionit.

Kërkesa e palëve të interesuara duhet të shoqërohet me dokumentet provuese për parashikimet e shkronjave “a”, “b” dhe “c”, si dhe një kopje të pasaportës së tyre të lëshuar nga shteti ku kanë vendbanimin e përhershëm.

“For some additions to law No. 8438, dated 28.12.1998, “On personal income tax”, as amended.

According to this act shall be exempt from income tax:

- Pension income and other similar remuneration of foreign nationals with albanian origin or of European Union countries with a residence permit in the Republic of Albania, as well as foreign nationals who have obtained albanian citizenship and are resident in the Republic of Albania and are entitled to such income under the legislation of the country in which they receive a pension or other similar remuneration.

To qualify for this exemption, beneficiaries must meet the following conditions:

- a) to be beneficiaries of a pension under the legislation in force in the countries where they have received it;
- b) have been equipped with a residence permit in the territory of the Republic of Albania;
- c) have never been convicted in their own state or in the Republic of Albania or any other State for offenses for which the law provides convictions of not less than 3 (three) years of imprisonment;
- d) have received a positive response from the responsible administrative structure for the personal income tax exemption of retirement benefits.

The request of the interested parties shall be accompanied by the proving documents for the predictions of letters "a", "b" and "c", as well as a copy of their passport issued by the country of permanent residence.

Sipas parashikimit në këtë akt në rast përgjigjeje negative ose të mungesës së përgjigjes nga struktura përgjegjëse administrative, brenda afateve ligjore të parashikuara, palës së interesuar i lind e drejta për ankimim administrativ, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

Personat përfitues humbasin të drejtën e përjashtimit nga tatimi mbi të ardhurat në kushtet e mosripërtëritjes së lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, kur për këtë nuk është bërë kërkesë në strukturat përgjegjëse deri 6 (gjashtë) muaj nga data e mbarimit të lejes.

Nëse dëshironi të dini më shumë për ndryshimet në legjislacionin shqiptar, na kontaktoni si më poshtë:

Email: info@arsfirm.al
Telefon: +355 69 97 89 625;
web: www.arsfirm.al

Adresa e zyrës
Rruga "Kavaja"
Qendra " Sun Tower "
8 Kati, Apt nr. 30
Tiranë, Shqipëri

©A.R.S Legal & Financial Services

According to the provision of this act, in case of a negative response or lack of response from the responsible administrative structure, within the legal deadlines provided, the interested party is entitled to an administrative appeal, according to the provisions of the Code of Administrative Procedures.

Beneficiaries lose the right to exemption from personal income tax in the case of non-renewal of residence permit in the Republic of Albania, when no request has been made to the responsible structures for up to 6 (six) months from the date of expiry of the permit.

If you wish to know more on Albanian legislation changes, contact us as follow:

Email: info@arsfirm.al
Phone: +355 69 97 89 625;
web: www.arsfirm.al

Office Address
"Kavaja" Street
"Sun Tower" Center
8th Floor, Apt no. 30
Tirana, Albania

©A.R.S Legal & Financial Services

